



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:058997

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876210

KPPP.nr.1358/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbaremore të kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në rr. "UÇK", në Prishtinë, kundër debitorit: "TEM" SH.P.K., me NUI: 810868185, me seli në Lagjen Kalabria, Blloku C6/1, Kati IV, Nr.15, në Prishtinë, , duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.84/23 të datës 23.02.2023 të Përmbaremit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit "TEM" SH.P.K., ANULOHET Urdhri Përmbaremore P.nr.84/23 i datës 23.02.2023, i Përmbaremit Privat Destan Bujupaj dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbaremi në këtë çështje përmbaremore.

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Prishtinës, ka lëshuar urdhrin përmbaremore P.nr.84/23 të datës 23.02.2023, me të cilin ka lejuar përmbaremin, në bazë të Aktvendimit 05Nr. 351/02-172283/21, të datës 20.09.2021 të Drejtorisë së Urbanizmit, Komuna e Prishtinës, t'ia paguajë kreditorit borxhin në shumën prej 138,914.13 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbaremore, nën kërcënimin e përmbaremit të dhunshëm, me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit, si dhe me sekuestrimin, vlerësimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbaremore duke theksuar ndër të tjerash se urdhri përmbaremore është lëshuar me shkelje të dispozitave të LPP-së, dhe se titulli ekzekutiv i propozuar nga kreditori nuk e paraqet gjendjen

reale dhe faktike të obligimit të mbetur nga ana e debitorit, pasi nga vlera e kërkuar në propozim nuk janë hequr pagesat e kryera nga debitori. Më tutje ka shtuar se Komuna e Prishtinës përmes Aktvendimit 05Nr. 351/02-172283/21, të datës 20.09.2021 e ka obliguar debitorin që si mjet garantues të deponoj garancionin e bankës ose të ndonjë kompanie të sigurimit, me ç'rast debitori e ka deponuar garancionin e garantuesit "SIGKOS" SH.A., me seli në Prishtinë dhe si rrjedhojë Komuna e Prishtinës ka qenë e detyruar që në afat prej 30 ditëve nga dita e skadimit të afatit për pagesën e këstit të katërt, ta informoj garantuesin e lartcekur për mos pagesën e këstit nga debitori dhe në këtë mënyrë ta inkasoj obligimin ndaj saj. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke theksuar ndër të tjera se dokumenti përmbarues i nxjerr në procedurë administrative/kundërvajtëse është bërë i përmbarueshëm sipas rregullave me të cilin rregullohet kjo procedurë përmbarimore. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit, të vërtetohet urdhri për përmbarim, si dhe të obligohet debitori që të përmbush obligimin sipas këtij urdhri së bashku me shpenzimet e procedurës përmbarimore deri në përfundim të kësaj çështje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundojë në tërësi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së, është përcaktuar se: "Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër". Ndërsa, sipas nenit 24.3 të LPP-së, "Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë".

Me nenin 27.1 të LPP-së, janë përcaktuar në mënyrë taksative elementet të cilat duhet ti përmbaj dokumenti përmbarimor për të shërbyer si dokument i përshtatshëm për përmbarim, ku sipas kësaj dispozite përcaktohet se: "*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për*

përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimi”.

Gjykata, duke ju referuar dispozitave të cituara si dhe bazuar në shkresa të lëndës, gjeti se Aktvendimi 05 Nr. 351/02-172283/21 i datës 20.09.2021, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë, përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbarrim të përcaktuara me nenin 24, paragrafi 3 dhe nenin 36 të LPP-së, pasi që i njëjti nuk është përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, me ç’rast edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet.

Përveç të metave të lartcekura, gjykata gjen se aktvendimi në fjalë nuk i plotëson as kushtet e përcaktuara në nenin 27.1 të LPP-së, pasi që në aktvendim është caktuar lartësia e taksës për leje ndërtimore pronarëve – persona fizik me investitor TEM” Sh.P.K., mirëpo nuk është përcaktuar se kush është i detyruar për pagesën e taksës dhe se nuk është treguar koha e përmbushje së detyrimit. Ndërsa, bazuar në pikën V të dispozitivit të këtij aktvendimit, pasojë e mos përmbushjes është përcaktuar refuzimi i lejes ndërtimore, dhe jo detyrimi për ekzekutim të dhunshëm të lartësisë së takës së caktuar për dhënien e lejes ndërtimore.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet.

Meqenëse gjykata gjeti se dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk përmban dokument përmbarrimor ngase nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si i tillë nuk mund të shërbej si dokument për të iniciuar procedurën përmbarrimore, gjykata nuk i trajtoi fare pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1358/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.